



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Njoftim për bashkëpunëtorë të jashtëm:

“Përgatitja e orëve interaktive për lëndët Matematikë-Fizikë-Kimi-Gjeografi të kurrikulës së re me kompetenca për klasat 7, 8 (AMU) për vitin 2016.

Instituti i Zhvillimit të Arsimit, mbështetur në nevojën për përgatitjen e orëve interaktive Matematikë-Fizikë-Kimi-Gjeografi të kurrikulës së re me kompetenca për klasat 7, 8 (AMU) për vitin 2016

Kandidatët e interesuar për të punuar si bashkëpunëtorë të jashtëm si ekspertë të angazhuar në përgatitjen e orëve interaktive duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

I. INFORMACION MBI POZICIONIN

Pozicioni: Mësues specialist /specialist i lëndëve të Shkencave të Natyrës për përgatitjen e orëve interaktive për klasat 7,8, (AMU)

Institucioni: Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti i Filologjisë

Periudha: Maj 2016- Dhjetor 2016

II. PËRSHKRIMI I POZICIONIT

Mësues specialist/specialist kurrikulë për përgatitjen e orëve interaktive Matematikë-Fizikë-Kimi-Gjeografi të kurrikulës së re me kompetenca për klasat 7,8 (AMU) për vitin 2016, që mundësojnë bashkëpunimin me koordinatorin DMTM , pranë IZHA-s, si dhe hartojnë planin e punës së detajuar për realizimin e produktit final.

III. ROLET KRYESORE TË POZICIONIT

Studion eksperiencën botërore mbi përdorimin e web-teknologjive gjatë realizimit të mësimit interaktiv në lëndët **Matematikë-Fizikë-Kimi-Gjeografi të kurrikulës së re me kompetenca për klasat 7,8 (AMU) për vitin 2016** nëpërmjet materialeve të marra nga interneti, të përshtatura me kurrikulën shkollore të arsimit bazë, duke bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me informaticienin ose programuesin për hartimin e orëve interaktive.

Përcakton temat e mësimeve interaktive që do të realizohen në bashkëpunim me specialistin e **Matematikë-Fizikë-Kimi-Gjeografi**. Zgjedh teknikat që do të përdoren për vizualizimin e orëve interaktive dhe aplikimin e tyre në kompjuter dhe tableta.

Harton dhe modifikon kodet java ose javascript tek appletet, physletet dhe animacionet që do të inkludohet në faqet html. Organizon punën në grup për mbledhjen e materialit tekstor që do të inkludohet në faqet html. Bën kompilimin e faqeve html për secilin nga mësimit. Shkruan të gjithë mësimit në CD-në përkatëse.

IV. KËRKESAT KYÇE TË POZICIONIT

4.1 Kualifikimet

- Diplomë universitare në fushën e Shkencave të Natyrës /Filologji
- Grada: Mësues mjeshtër/ Specialist lëndor pranë AKP, DAR, MAS
- Titulli: Mësues mjeshtër/ mësues specialist/specialist lëndor
- Përvojë pune në grup;
- Zotëron aftësi të shkëlqyera për përdorimin e kompjuterit;
- Harton **programe në gjuhët BASIC dhe FORTRAN** ;
- Zhvillon aplikime nga fusha të ndryshme me **Visual Basic**;
- Përdor **Java Apletet** në demostrime dhe vizualizime eksperimentesh në lëndët fizikë, matematikë, kimi, gjeografi.
- Ka rrjedhshmëri në përdorimin e gjuhës angleze.
- Ka përvojë të mëparshme në hartimin e orëve interaktive, dhe zotëron shumë mirë kurrikulën shkollore të Arsimit Bazë.

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin këto dokumenta:

- Kërkesë për aplikim
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit
- Cv
- Fotokopje e diplomës së shkollës së lartë
- Përmbledhje e shkurtër e analizave dhe studimeve në përgatitjen e orëve interaktive

Dokumentat duhet të dorëzohen pranë sekretarisë së Institutit të Zhvillimit të Arsimit, brenda datës 30.11.2016.

Faleminderit!